



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2022:074542

Datë: 29.05.2024

Numri i dokumentit: 05753533

KPPP.nr.1716/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti Ekonomik, Gjyqtari Alajdin Tërshnjaku, në çështjen juridike-përmbartimore të kreditorit Kompania Rajonale Ujësjetllësi “Prishtina” Sh.A., me seli në Prishtinë, rr. Hazir Shala, kundër debitorit Le Bouchon Sh.P.K., me seli në Prishtinë, rr. Fazli Grajçevci 24, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit të ushtruar kundër Urdhrit Përmbartimor P.nr.29/2022 të datës 28.02.2022, të Përmbartuesit Privat Emine Sherifi-Lubëniqi, me seli në Prishtinë, jashtë seancës me datën 17.05.2024 mori këtë:

A K T V E N D I M

PRANOHET si i bazuar prapësimi i debitorit Le Bouchon Sh.P.K., ANULOHET urdhri përmbartimor P.nr.29/2022 i datës 28.02.2022, i lejuar nga Përmbartuesi Privat Emine Sherifi-Lubëniqi.

A r s y e t i m

Përmbartuesi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit Kompania Rajonale Ujësjetllësi “Prishtina” Sh.A., ka caktuar urdhrin përmbartimor P.nr.29/2022 të datës 28.02.2022, duke lejuar përmbartimin në bazë të dokumenteve të besueshme – Kartelës Financiare të Konsumatorit shifër 1738, me të cilin është obliguar debitori që në afatin prej 8 ditësh nga dita e pranimit të këtij urdhëri, t’ia paguaj kreditorit borxhin prej 2,226.55 Euro, si dhe shpenzimet përmbartimore në përputhje me Udhëzimin Administrativ UA-MD Nr.06/2014 për Tarifat,

Shpërblimet dhe Kompensimin e Shpenzimeve për Përmbaruesit Privat, nën kërcënim të përmbarimit të dhunshëm, me ndalimin e mjeteve në para të cilat debitori i ka në xhironlogarinë e tij bankare, dhe bartjen e shumës përkatëse në xhironlogarinë bankare të kreditorit, ose nëse debitori nuk ka mjete në xhironlogarinë e tij, me konfiskimin dhe shitjen publike të sendeve të luajtshme të debitorit dhe bartjen e atyre mjeteve në xhironlogarinë e kreditorit.

Kundër urdhrorit për lejimin e përmbarimit brenda afatit ligjor debitori ka paraqitur prapësim duke theksuar se kompania Le Bouchon Sh.P.K., është regjistruar me datën 05.05.2017, dhe ka marrë objektin me qera që nga data 01.07.2017, andaj koha e mëparshme e borxhit nuk i takon kësaj kompanie për atë objekt. Më tej ka shtuar se kjo kompani, ka shitur të gjithë asetet dhe aktivitetin e saj me datën 31.08.2020, dhe gjithashtu ka liruar objektin e qerasë kompanisë të cilës ia ka shitur asetet, kompanisë Bruni Sh.P.K., e cila ka shfrytëzuar objektin dhe ujin që nga data 31.08.2020. Ka shtuar se kompania Le Bouchon ka marrë objektin me borxhin zero, në korrik të vitit 2017 dhe ka lëshuar objektin me borxhin zero tek Ujësjellësi i Prishtinës me datën 31.08.2020. Debitori ka potencuar se kjo procedurë përmbarimore është pa bazë ndaj Le Bouchon Sh.P.K., ngase datat nuk përputhen me aktivitetin e kësaj kompanie, dhe kjo mund të shihet në dokumentin e quajtur “propozim me prova”.

Kreditori, në afatin e paraparë ligjor ka parashtruar përgjigje në prapësim, duke kundërshtuar në tërësi prapësimin e debitorit si të pabazuar, të pa argumentuar si dhe pa mbështetje në ligj dhe prova. Tutje ka theksuar se kreditori faturimin e bën në bazë të Rregullores nr.10/2019 për standardet minimale të shërbimit të ujit në Kosovë, dhe në rastin konkret debitorin e ka faturuar me ujëmatës që për kreditorin është e rëndësishme që pronari i objektit Le Bouchon Sh.P.K., duhet t’i paguaj detyrimet ndaj kreditorit. Ka shtuar se bazuar në Rregulloren nr.13/2021 të ARRU-së, neni 5, debitori ka për obligim të njoftoj me shkrim kreditorin lidhur me ndërrimin e emrit të shfrytëzuesit të shërbimeve të KRU “Prishtina” Sh.A., njoftim/kërkesë të cilin debitori nuk e ka bërë. Andaj, ka propozuar që prapësimi i debitorit të refuzohet si i pabazuar dhe i pa argumentuar, si dhe të obligohet debitori që të kryej obligimin ndaj kreditorit, dhe me rastin e ankesës t’i caktojë debitorit shumën e garancionit deri në vlerën e propozimit sipas nenit 77 par.5 dhe nenit 78 par.1/2 të LPP-së.

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim, deklarimeve të kreditorit të paraqitura në përgjigje në prapësim, si dhe pas shqyrtimit dhe

vlerësimi të provave që gjenden në shkresat e lëndës, e duke i'u referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligjit Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbartimore, (tutje LPP) gjeti se prapësimi i debitorit është në tërësi i bazuar, andaj, të njëjtin e aprovoi dhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi, për shkaqet si në vijim:

Gjykata vlerëson se organi përmbartues ka lejuar përmbartimin bazuar në nenin 21 të LPP-së i cili përcakton se: *“Organi përmbartues e cakton, përkatësisht e zbaton përmbartimin vetëm në bazë të dokumentit përmbartues (titulus executionis) dhe dokumentit të besueshëm, po qe se me këtë ligj nuk është parashikuar diçka tjetër.”*

Gjykata vlerëson se në rastin konkret Kartela financiare e konsumatorit me shifër 1738, në bazë të së cilit është lejuar urdhri për përmbartim, nuk i plotëson kushtet e parapara me nenin 43 paragrafi 1 dhe nenin 37 të LPP-së.

Sipas nenit 43 par.1 të LPP-së, përcaktohet se *“Në aktvendimin për përmbartimin dhe urdhrin për përmbartim në bazë të titullit përmbartues duhet të tregohet dokumenti përmbartues, kreditori dhe debitori i përmbartimit, kredia që duhet të realizohet, mjeti dhe objekti i përmbartimit, si dhe të dhënat tjera të nevojshme për zbatimin e përmbartimit”*. Me nenin 29 par.3 të LPP-së, përcaktohet se *“Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbartim po qe se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar”*, ndërsa me nenin 37 të LPP-së, përcaktohet se *“Kur propozimi për përmbartim paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimit t'i bashkëngjitet dokumenti i tillë origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit.”*, kurse sipas nenit 29 paragrafit 1 nën paragrafit 1.2 të LPP-së, ekstraktet e verifikuara nga librat afariste për pagesat e shërbimeve komunale të furnizimit me ujë, energji elektrike dhe bartjen e mbeturinave janë përcaktuar si dokument i besueshëm sipas të cilit mund të caktohet përmbartimi për realizimin e kërkesës në të holla.

Gjykata duke u bazuar në të lartcekurat gjeti se dokumenti - Kartela Financiare e Konsumatorit me shifër 1738, në bazë të së cilit është lejuar propozimi për përmbartim e cila i ka atributet e një ekstrakti nga librat afarist i cili parashihet si dokument i besueshëm në kuptim të nenit 29, par. 1, nën-par. 1.2 të LPP-së, nuk i plotëson kushtet ligjore për të qenë dokument i pranueshëm, për faktin se nuk i përmban tiparet e një ekstrakti nga librat afarist, meqenëse në këtë dokument nuk evidentohet saktësisht periudha kohore për të cilën kërkohet përmbushja e detyrimit.

Nga ekstrakti afarist i bashkëngjitur sipas shifrës 1738, rezulton se borxhi në shumën prej 2,226.55 €, është kërkuar për periudhën kohore nga data 01.01.2013 deri me datën 25.02.2022, ndërsa në përmbajtjen e këtij ekstrakti, nuk është përfshirë fare periudha prej datës 01.01.2013 deri me datën 30.12.2013, dhe periudha nga data 01.02.2022 deri me datën 25.02.2022, me ç' rast nuk dihet se për cilat shërbime dhe për cilën periudhë kohore është grumbulluar borxhi në fjalë.

Andaj, duke u bazuar në të lartcekurat gjykata vlerëson se në rastin konkret dokumenti i besueshëm - Ekstrakti nga Kartela Financiare e Konsumatorit me shifër 1738, e mbi bazën e të cilit Përmbaruesi Privat ka lejuar përmbarimin, nuk ka tipare të përmbarueshmërisë dhe si rrjedhojë edhe urdhri i lejuar nga ana e Përmbaruesit Privat duhet të anulohet.

Meqenëse dokumenti në bazë të së cilit është lejuar urdhri përmbarimor, përkatësisht kartela e konsumatorit me shifrën 1738 nuk ka tipare të përmbarueshmërisë, gjykata nuk i shqyrtoi fare pretendimet tjera të debitorit të paraqitura në prapësim dhe kreditorit të paraqitura në përgjigjen në prapësim dhe duke u bazuar në nenin 71 par. 1.1 dhe 73 të LPP-së, nenin 12 par. 2 të Ligjit Nr. 05/L-118 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbarimore, si dhe nenin 13 par.1 nën par 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike
KPPP.nr.1716/23, datë 17.05.2024

Gjyqtari
Alajdin Tërshnjaku

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimit të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale, përmes Dhomave të Shkallës së Parë të kësaj Gjykate.